



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 23/09**

**Prishtinë, më 17.06.2009, ora 14:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Xhevdet Neziraj.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: Saša Rasić, Ministër nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, monitruer nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante) dhe Gazmend Avdyli (praktikant).

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 20.05.2009
3. Shqyrtim i propozim - amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre me raportin komisionit funksional - Komisioni për Buxhet e Financa;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
6. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, njoftoi se grupi punues i Komisionit, ka mbajtur një takim dhe ka përgatitur një raport lidhur me detyrat e komisionit që dalin nga plan veprimit të Kuvendit. Prandaj propozoi të bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës, të shtohet një pikë e re plotësuese - pika 3, në të cilën do të diskutohet dhe miratohet raportit i komisionit si përgjigje e detyrave që dalin nga plani i veprimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi**, konstatoi se rendi i ditës miratohet me plotësim. Shtohet një pikë e re si pika e tretë: Miratimi i raportit lidhur me detyrat e Komisionit të përcaktuara me Propozim Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 20.05.2009**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 20 maj 2009, u miratua pa vërejtje.

### **3. Miratimi i raportit lidhur me detyrat e Komisionit të përcaktuara me Propozim Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008**

**Kryesuesi**, njoftoi se arsyeja e prezencës së Ministrit në mbledhje është ofrimi i informacioneve zyrtare për numrin e të kthyerve në Kosovë, ashtu siq kërkohet edhe planin e veprimit.

**Saša Rasić, Ministër i MKK**, njoftoi se jemi në proces të krijimi të softuerit të bazës së të dhënave për të kthyerit. Kompania e obliguar ende nuk ka kryer punën, nuk është bërë pranimi teknik. Megjithatë që nga janari 2009 baza e të dhënave është në shfrytëzim. Deri më tani MKK-ja ka pranuar 424 aplikacione nga UNHCR, nga të cilat për 194 familje është bërë vlerësimi e ndihmave sociale nga UNHCR/KAAD.

**Zylfi Merxha**, theksoi se nga ky raport i Ministrit shifet se nuk ka as një të kthyer nga komuniteti rom dhe asnjë projekt për këtë komunitet.

**Sanije Aliaj**, lexoi propozimet e grupit punues si përgjigje ndaj detyrave të Komisionit të përcaktuara me Propozim Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës. Kërkoj nga anëtarët të deklarojnë për këto propozime apo edhe të japin mendimet e tyre për mundësinë e plotësimit apo të ndryshimit të tyre. Komisioni duhet që sot të votojë raportin, sepse i njëjti do të dërgohet Komisionit për Integritet Evropian deri më 19 qershor që është edhe koha e fundit për dorëzim e raporteve të komisioneve lidhur tre mujorin e parë të përmbushje së detyrave që dalin nga ky plan i veprimit.

**Numan Balic**, vlerësoi punën e grupit punues që paraqet lëvizje pozitive në drejtim të interesimit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Propozoi që në tryezën e rrumbullakët të ftohen edhe përfaqësuesit e Zyreve lokale për Komunitetet të Komunës së Istogut dhe Dragashit. Gjithashtu u pajtua që në takimet e ardhshme të diskutohet për pikat e caktuara që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore të të gjitha komuniteteve, të diskutohet për problemet me literaturën në gjuhën boshnjake

dhe në gjuhë tjera. Të mësohet edhe për numrin e të shpërngulërve si dhe të monitorohet çështja e fondit për pakicat.

**Müfera Şinik**, urojë për punën e bërë nga grupi punues. Kërkoi një sqarim të paraparë në fq. 17 takimi i tri entiteteve.

**Kosara Nikolic**, theksoi se çështjet e të kthyerve komuniteti malazez nuk është përmendur fare, edhe pse kam informacione se janë kthyer. Prandaj kërkoi që në raportet e veta komisioni do të interesohet edhe për komunitete dhe mos të përsëritet gabimi që është bërë në Kushtetutë.

Pasi propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Miratohet raporti i Komisionit lidhur me detyrat të përcaktuara për tre mujorin e parë me Propozim Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

### **4. Shqyrtim i propozim - amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre me raportin komisionit funksional - Komisioni për Buxhet e Financa**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar propozim - amendamente plotësuese lidhur më Projektligjin për partneritet publiko – private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Kryesuesi**, theksoi se me rastin e miratimit në parim të këtij projektligji, ka pasur vërejtje se nuk do të duhej kalojë, pa u miratuar Ligji i Punës.

**Sadik Idriz**, si komision funksional gjithashtu kemi menduar që të kthejmë këtë ligj Qeverisë, deri në miratimi e Ligjit të punës.

Pasi sugjerimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **7. Të ndryshme**

**Numan Balic**, njoftoi për vizitat që ka realizuar grupi punues i komisioni për mbikëqyerjen e ligjeve, në KEK dhe Dogana, ndërsa kemi pasur problem në realizimin e vizitës së paraparë në PTK, për të cilën do të duhej cekur edhe në raportin e drejtuar Kuvendit se na kanë refuzuar.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

**Bojan STOJANOVIĆ**